



Primeshje / Dategimi / Prilaz / Prilaz / Received / Delivery	20.10.2022	2	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jednica / Org. / Unit	No. Prot. / No. Prot. / Prot. No.	Shitja / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKIMSHICK	6351/2022		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.754/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.754/2022 të datës 31.08.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë fshati në Komunën e Kamenicës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 20.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.754/2022, e datës 31.08.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Komuna e Kamenicës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 12.04.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 04.05.2022 ka shpallur për aplikim konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë Ligjor, lidhur me pozitën "Referent" në Komunën e Kamenicës për klasën e pozitës profesional 4.

Ankuesja me datën 10.05.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë e përfshirë deri në fazën e testimit me shkrim, bazuar në njoftimin me numër Reference RN00008796 i gjeneruar tek SIMBNJ të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Kamenicës se del se e njëjta është njoftuar lidhur me pikët e arritura, gjithsejtë 39.0 pikë, duke u renditur e njëmbëdhjeta (11) në listën përfundimtare.

E pa kënaqur me rezultatin lidhur me rezultatin e testimit me shkrim, me datën 29.06.2022, ankuesja ka parashtruar ankesën me numër të protokollit Sh.02.Nr.20144 tek Komisioni për vlerësim, me pretendimet ankimore se në testin me shkrim ka pasur manipulime nga ana e

komisionit të pranimit, se të njëjtën kanë pasur për qëllim ta largojnë nga pozita të cilën e ka mbajtur, se njëri anëtar i komisionit nuk ka qenë pjesëmarrës nga DGJKP-ja etj.

Me datën 04.07.2022, Komisioni për vlerësim përgjegjës për vlerësimin e procedurave të lartcekura në Komunën e Kamenicës, ka nxjerrë Vendimin me numër Sh.02.Nr.20660 sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa pranueshme dhe e ka lënë në fuqi njoftimin lidhur me rezultatin e arritur në testin me shkrim të kandidatëve i shpallur në HRMIS.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin e komisionit të vlerësimit në Komunën e Kamenicës lidhur me refuzimin e ankesës se saj si dhe vendimit lidhur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatëve fitues, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 31.08.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5048/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se është degraduar profesionalisht pasi që është pranuar personi me shkollim të mesëm, zgjedhja e personit për këtë pozitë ka qenë politike, se kandidati i përzgjedhur e ka pasur testin e shkrim... etj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 05.09.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, ndërsa me datën 15.09.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Kamenicës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 12.10.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.116/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:5048/2022 të datës 31.08.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokumentacionin me numër CLC22009 të datës 13.07.2022; Ankesën e ankueses me numër Sh.02.Nr.20144 të datës 29.06.2022 e parashtruar tek Komisioni i Vlerësimit; Vendimin me numër Sh.02 Nr.20666 të datës 04.07.2022 nga ana e Komisionit të Vlerësimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë të datës 15.09.2022 nga Komuna e Kamenicës së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; E-mailin zyrtar të datës 09.09.2022; Flet kthesën e datës 13.07.2022 lidhur me dërgimin e vendimit të komisionit të vlerësimit për ankuesen; Lista për renditjen përfundimtare të kandidatëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Listën e aplikantëve e gjeneruar tek Simbnj; Njoftimin për rezultatet përfundimtare të vlerësimit, Specialist Ligjor/Referent nga NJBNJ të datës 03.08.2022 me numër Nr.100; Konkursin nga Komuna e Kamenicës të datës 12.04.2022; Aplikacionin e kandidatës te datës 11.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale atë të punës dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatës B. M të datës 11.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatit F. H të datës 10.05.2022 së bashku



me diplomën e shkollës së mesme; Aplikacionin e kandidatës F. D të datës 11.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës dhe certifikatën nga gjykata; Aplikacionin e kandidatës K. M- B të datës 11.05.2022 së bashku me dëshminë për certifikatën nga gjykata ; Aplikacionin e kandidatës L.J të datës 10.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës si dhe përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacioni i kandidatës L.O të datës 11.05.2022; së bashku me dëshmitë mbi përgatitjen profesionale dhe ID-në; Aplikacionin e kandidatës L.D të datës 05.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës dhe kopjen e letërnjoftimit ; Aplikacionin e kandidatës M.B të datës 05.05.2022 së bashku me dëshmitë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacionin e kandidatës N. Sh të datës 04.05.2022 së bashku me dëshmitë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës dhe kopjen e letërnjoftimit si dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatës V.K të datës 08.05.2022 së bashku me dëshmitë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës , kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatën nga gjykata; Aplikacionin e kandidatës V. V të datës 06.05.2022 së bashku me dëshmitë mbi përgatitjen profesionale dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatës Sh.M të datës 09.05.2022 së bashku me dëshmitë mbi përgatitjen profesionale dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e kandidatit Sh. L të datës 05.05.2022 së bashku me dëshmitë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës si dhe Vendimin VK.nr.116/2022 të datës 12.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa lejuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës del se, ankuesja fillimisht me datën 29.06.2022 ka parashtruar ankesën me numër Sh.02 Nr.20144 tek Komisioni i Vlerësimit në Komunën e Kamenicës, ndërsa ky i fundit me datën 04.07.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Sh.02 Nr.20666, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa pranueshme .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se bazuar në Fletë kthesën nga Posta e Kosovës të datës 13.07.2022, del se ankueses vendimi lidhur me refuzimin e ankesës të Komisionit të Vlerësimit në Komunën e Kamenicës, i është dorëzuar përmes postës me datën 04.07.2022, ndërsa ankuesja këtë vendim e ka pranuar me datën 12.07.2022, kurse ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datën 31.08.2022, e që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : ***"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ"***, andaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankueses mbi këtë bazë ligjore është e pa lejuar.

Andaj, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore

në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.754/2022, datë 20/10/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.